

Mekanizmi i Llogaridhënies

WORLD VISION SHQIPËRI DHE KOSOVË

World Vision është një organizatë ndërkombëtare humanitare e krishterë, zhvillimi komunitar dhe advokuese.

Në Shqipëri, World Vision filloi të punonte në 1999-ën, si përgjigje ndaj krizës së refugjatëve kosovarë. Prej dy dekadash, puna jonë është fokusuar tek zhvillimi dhe mbështetja afatgjatë për fëmijët, adoleshentët e të rinjtë dhe komunitetet më në nevojë në Shqipëri. Puna jonë ndikon në jetën e mbi 60 mijë fëmijëve dhe 43,000 të rriturve, në 24 bashki. Ne mbështesim dhe punojmë për fuqizimin e fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve më në nevojë. Mbrojtja e përfshirja sociale, aktivizmi rinor dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik për familjet në nevojë janë fokusi i punës sonë. World Vision angazhohet për të sjellë ndryshim të qëndrueshëm dhe rritjen e mirëqënies për fëmijët dhe familjet në Shqipëri.

SJELLJET E PRITSHME

Punonjësit e World Vision Shqipëri dhe Kosovë dhe partnerët tanë:



- Duhet të trajtojnë çdo njeri me respekt, dinjitet dhe paanshmëri.
- Duhet të sillen në mënyrë të besueshme dhe etike.
- Nuk duhet të përdorin dhunë, kërcënim apo të përfshihen në sjellje të dhunshme.
- Nuk duhet të kenë sjellje/qëndrime/marrëdhënie që favorizojnë abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve (personave nën 18 vjeç) apo të përfituesve të programit/projektit.

PROGRAMI YNË SYNON



Fëmijët në Shqipëri dhe Kosovë të jetojnë në një mjedis gjithëpërfshirës, të sigurt dhe të mbrojtur, me mundësi për të ardhmen e tyre. World Vision në Shqipëri dhe Kosovë punon në tre sektorë: Mbrojtja e fëmijëve, Edukimi dhe Rinia, si dhe Zhvillimi ekonomik dhe rezilienca në komunitet.

Në këtë kuadër ky poster ka si qëllim informimin e fëmijëve, të rriturve, të çdo partneri apo donatori mbi ekzistencën e Mekanizmit të Llogaridhënies në World Vision Shqipëri dhe Kosovë. Kjo është një mundësi që u jepet të adresojnë në mënyrën e duhur sugjerimet, mendimet, komentet dhe ankesat që ata mund të kenë për projektet/programet e World Vision Shqipëri dhe Kosovë.

SI MUND TË NA KONTAKTONI?

Dhënia e mendimit, komenteve mbi punën tonë dhe ankesave është e drejta juaj. Ne i mirëpresim sugjerimet, komentet, mendimet dhe ankesat tuaja në mënyrë që të përmirësojmë punën tonë.

Ju mund të lidheni me ne përmes linjës telefonike **068 40 75 263**, nga e hëna në të premte, ora **09.00-15.00** dhe përmes emailit llogaridhenia@wvi.org

Sugjerimet, mendimet, komentet dhe ankesat tuaja do të regjistrohen dhe ju do të merrni një përgjigje duke respektuar të drejtën e konfidencialitetit dhe anonimatit.